



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.757/ 1 Prot.

Tiranë, më 16.05.2024

**V E N D I M**

**Nr. 134, Datë 16. 05. 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.69 Regj., datë 03.04.2024 të ankueses znj. E. J, në cilësinë e përfaqëueses ligjore të vajzës së saj znj. M. J, kundër Gjendjes Civile Elbasan dhe Maternitetit Elbasan, për shkak të “*racës*”.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Pretendimet sipas subjektit ankues.**

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, ankuesja parashtron se: *Unë jam E. J, e ema e M. J, problematika ime qëndron në faktin se unë kam lindur Meritën në martentitetin e qytetit të Elbasanit dhe nuk më është dhënë asnjë dokument nga materniteti dhe sot e kësaj dite M. J, rezulton e paregjistruar në gjendjen civile gjithashtu dhe fëmijët e saj 2 vjeç dhe 3 muajsh*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

rezultojnë të pa regjistruar. M. J, e lindur në qytetin e Elbasanit (materniteti i Elbasanit) sot është afërsisht 30 vjeçe. M. ka mbi 20 vite që jeton në qytetin e Shkodrës por familja e saj e ka pashaportizimin në qytetin e Elbasanit dhe kjo ka sjellë dhe për në vështirësi për të bërë të mundur regjistrimin e saj. Ne kemi kontaktuar me drejtorin e Gjendjes Civile Elbasan (me asistencën e MALTESER Shkodër), i cili na ka thënë se nuk mund të bëhet regjistrimi dhe ti drejtohem TLAS (të cilët nuk kanë kthyer përgjigje) që të bëjnë ADN-në (sms i keni të printuara bashkëngjitur ankesës). I jemi drejtuar dhe Maternitetit të Elbasanit të cilët nuk gjejnë dokumentit e lindjes së Meritës dhe na kanë sjellë një dokument (dokumenti me datë 20.09.2023) të motrës së Meritës e cila ka vdekur, kjo vërtetohet nga data në aktin e vdekjes së M. J (motra e M.) dhe data e lindjes e maternitetit janë njësoj. Në certifikatën familjare time E. J, nuk figuron M., në asnjë dokument. M., nuk mund të përballojë kostot e testit të ADN-së. E gjitha kjo është një diskriminim sepse përveç faktit që diskriminohet për shkak të racës ajo dhe fëmijët e saj privohet nga çdo shërbim që duhet të marrin në shetin tonë. Nga ana tjetër M., ka lindur dhe dy fëmijë të cilët po ashtu nuk janë rregjistruar.

Masat që kërkohen të merren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë ndalimi i diskriminimit dhe regjistrimi i vajzës time M. J.

### **Procedurat e ndjekura nga Komisioneri**

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dha akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankueses me shkresën nr.534/1 prot., datë 08.04.2024, ku u kërkua informacioni si mëposhtë:

- Në Deklaratën e datës 03.04.2024 shpreheni se vajza juaj e moshës afërsisht 30 vjeç nuk dëgjon dhe nuk flet dhe për këtë arsye do të përfaqëohet nga ana juaj në këtë ankimim. Në këto kushte, për tu pranuar kjo Deklaratë, duhet të shoqërohet me një vërtetim nga institucioni përkatës, i cili të vërtetojë gjendjen shëndetësore të pretenduar të vajzës. Në të kundërt jeni të lutur të paraqisni aktin e përfaqësimit që keni tagrin ligjor për të përfaqësuar vajzën tuaj në këtë shqyrtim administrativ.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështje të ankesës tuaj.

Sa sipër, duke marrë shkas nga moskthimi i një përgjigjeje nga ana e ankueses, nga inspektori i çështje u telefonua në numrin e telefonit të shënuar në formularin e ankesës ku rezultoi që i përkiste përfaqësues të Shoqatës MALTESER Shkodër.

Me email e datës 25.04.2024, nga ana e inspektorit të çështjes, u dërgua në adresen e email: nuncia.gajtani@malteser.al, shkresa nr.534/1 prot., datë 08.04.2024 e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për plotësimin e informacionit të kërkuar me këtë shkresë.

Ndërkohë dhe adresa e shënuar në formularin e ankesës së znj. E. J, ishte adresa e Shoqatës MALTESER Shkodër, dhe si rezultat nga shërbimi postar, u kthye zarfi i dërguar në adresën e ankueses.

Me email e datës 29.04.2024, Shoqata MALTESER Shkodër, ka kthyer një përgjigje për llogari të ankesës së znj. E. J, ku është shprehur se: *Ju falenderojmë për informacionin dhe reagimin tuaj. Ne e vlerësojmë shumë këtë. Lidhur nga më sipër në deklarojmë që në adresën e vënë në kërkesë nuk ka ardhur akoma një shkresë e tillë. Sido me interesin për zgjidhjen e rastit deklarojmë se për një person pa një mjet identifikimi është i pamundur plotësimi i kërkesave, konkretisht:*

*- Nuk ka nje mjek i cili mund të deklaroje gjendjen shëndetësore të një pacienti pa identitet apo mjet idetifikimi. Theksojmë, personi nuk përfiton asnjë shërbim mjekesor!!!! Nëse Ju keni një mjek i cili mund të vërtetojë gjendjen shëndetësore të një personi pa një mjet idetifikimi jemi të gatshëm të bashkëpunojmë në lehtësimin e kësaj procedure.*

*- Për sa i përket aktit të perfaqësimit po ashtu edhe pse jemi interesuar, nuk e marrin përsipër një shërbim të tillë, duke qenë se për një person të pa identifikueshëm nuk mund të realizohet një procedurë e tillë. Në këto kushte ne jemi të hapur të bashkëpunojmë me ju në gjetjen e mundësive të tjera për zgjidhjen e rastit.*

### **Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe

diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur nënen 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshteruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, germa a) parashikon shprehimisht se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”*

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një

ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. *Ankesa nuk pranohet nëse: ....ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;*”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Pala ankuese pretendon diskriminim të vajzës së saj nga ana e Maternitetit të Elbasanit dhe Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, në lidhje me mosregjistrimin nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, të vajzës së saj M. J, si rezultat i moslëshimit të aktit të lindjes nga Materniteti i Elbasanit.

Në Deklaratën e datës 03.04.2024, ankuesja është shprehur se vajza e saj ka e moshën afërsisht 30 vjeç dhe nuk dëgjon dhe nuk flet dhe për këtë arsye do të përfaqësohet nga ana saj në këtë ankimim.

Në këto kushte, për tu pranuar kjo Deklaratë, nga ana e Komisionerit, u kërkua që deklarata të shoqërohej me një vërtetim nga institucioni përkatës, i cili të vërtetojë gjendjen shëndetësore të pretenduar të vajzës. Në të kundërt për të vijuar me trajtimin e mëtejshëm të kësaj ankese duhet akti i përfaqësimit që ka tagrin ligjor për të përfaqësuar vajzën e saj në këtë shqyrtim administrativ. Nga ana e ankueses nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa e znj. E. J, vjen në kundërshtim me përcaktime ligjore të parashikuara në nenin 35 të Kodit të Procedurës Administrative, ku përcaktohet se: *1. Pala mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, në përputhje me parashikimet e këtij Kodi. 2. Në rastin kur pala vepron e përfaqësuar, organi publik kryen veprimet procedurale me përfaqësuesin. 3. Organi publik mund të kërkojë kryerjen e një ose disa veprimeve procedurale drejtpërdrejt nga pala, në rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji. Në këtë rast, organi publik njofton edhe përfaqësuesin.*

Në lidhje me problematikën e ankueses, sjellim në vëmendje se referuar Planit Kombëtar të Veprimit "Për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë", (2021-2025)<sup>3</sup>, një nga objektivat të qeverisë është: Objektiv i specifik 2. Garantimi i Shërbimeve të Ndhmës Juridike Falas Për romët dhe Egjiptianët, ku prashikohet se: *Marrja e kartave të identitetit/regjistrimi në regjistrin e gjendjes civile në mungesë të certifikatës së lindjes kërkon ndihmë ligjore/administrative, të cilën shumica e romëve nuk di ku ta marrë dhe nuk mund ta përballojë financiarisht. Zyrat e gjendjes civile, nën presionin e njërive vendore, refuzojnë lëshimin e kartave të identitetit nëse aplikantët nuk kanë paguar taksat vendore, pavarësisht faktit që një praktikë e tillë është denoncuar nga Ministria e Brendshme. Plani i ri parashikon përfundimin e regjistrimit të posacëm të përkohshëm që do të krijojë bazën e të dhënave e cila do të japë mundësinë për trajtim dhe zgjidhje sipas rastit personave që nuk janë regjistruar dhe regjistrimin dhe zgjidhjen, përmes zyrave të gjendjes civile, e rasteve të individëve të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm. Gjithashtu plani parashikon ngritjen e shërbimeve të lëvizshme të ndihmës ligjore falas për romët dhe egjiptianët si dhe ofrimin e ndihmes juridike parësore dhe dytësore. Ndhma juridike/administrative për regjistrimin civil ofrohet kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga shërbimi i ndihmës juridike nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë.*

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektin ankues, që, për problematikën e tij, t'i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike<sup>4</sup>, ose Shërbimit Ligjor Falas<sup>5</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, germa "ç", të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese znj. E. J, kundër Maternitetit të Elbasanit dhe Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, nuk mund të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur hetimin dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 20, pika 1, germa "a", nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4, germa "ç" të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr.69, datë 03.04.2024, së znj.E. J, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i

<sup>3</sup> Miratuar me VKM-në nr. 18.11.2021.

<sup>4</sup> Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi "Zogu i Parë", Tiranë.

<sup>5</sup> Me adresë: Bulevardi: "Bajram Curri", Pall: "Agimi", Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Tel: 0422 53113.

ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**